

P. nr. 73/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me procesmbajtësen Flutur Nagavci , në çështjen penale kundër të akuzuarit Q. G. nga Gjakova , për shkak të veprës penale ndotje ,degradim o se shkatërrimi mjedisit nga neni 347 par.2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP.nr.1733/17 të dt.19.01.2018 ,në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **31.08.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj , perf.i autorizuar i te dëmtuarës L. L. sipas autorizimit si dhe të akuzuarit Q. G. , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Q. G.** nga Gjakova, rruga ““ , nga i ati I dhe nënës R e gjinisë V, data e lindjes ne Gjakove, ka te kryer shkollën fillore, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i martuar at i 2 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r

Për shkak se :

-me dt. 13.11.2017, rreth orës 13.00 ne fsh.M. K Gjakovë ,shkel Ligin për Mbrojtje dhe Mjedisit ,i cili garanton te drejtën çdo personi për një mjedis ekologjikisht te pranueshëm dhe te shendosh ,si e drejtë themelore kushtetuese ne atë mënyrë qe pasi i merr mbeturinat (mbetjet materialit ndërtimor) nga një person tjetër ,te njëjtat i hedh buzë lumit “E”,veprime këto qe ndotin mjedisin ,jetën dhe shëndetin e njeriut .

-me çka ka kryer veprën penale ndotje ,degradim o se shkatërrimi mjedisit nga neni 347 par.2 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,7,17,41,49,50,51, 73 ,neni 347 par.2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit ia shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **2(dy) muajve** i cili dënim nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1 (një) viti ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara KK ne Gjakove, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1733/17 të dt.19.01.2018, e ka akuzuar të akuzuarin Q. G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale ndotje, degradim ose shkatërrimi mjedisit nga neni 347 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 31.08.2018 lexon aktakuzën PP.nr.1733/17 dt. 19.01.2018, deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, por sa i përket kualifikimit juridik pikërisht nenit 347 të KPRK-se, i shtoi paragrafi 2 ku kualifikimi juridike duhet të jete vepra penale ndotja degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.2 të KPRK-se, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari Q. G., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjendje e tillë është konstatuar, këtë veprë e kam kryer duke mos ditur se jam duke bere shkelje të Ligjit, e që për shkak të kushteve të dobëta ekonomike si person i pa punësuar ku jam ushqyes i vetëm i familjes 6 anëtarësh kam bere bartjen dhe hedhjen e mbeturinave e angazhuar nga një person tjetër me qëllim të fitimit të një shume prej 5 € për mbajtje të familjes. Shtoi se jam penduar për veprë e kryer nga pakujdesia premtoi se një veprim i tille nuk dot e përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, andaj I propozoj gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimi i fajësisë, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, si dhe faktin se është hera e pare që kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës KRM “Ç” L. L., deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por konsideroi se pala e dëmtuar në këtë rast është Komuna e Gjakovës, dhe jo Kompania “Ç”, për arsye se Kompania është e licencuar vetëm për bartje dhe grumbullim të mbeturinave dhe në vendin përkatës në Stacion transfer në Gjakovë, dhe në kompaninë Regjionale për grumbullimin e mbeturinave - deponia në L. Komuna e Prizrenit. Menaxhimi i deponime ilegale dhe lumenjve si në rastin e caktuar është kompetent e Organeve Komunale të Komunës së Gjakovës. Prandaj nuk e konsiderojmë veten si pale e dëmtuar.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike të pranimi të fajësisë, dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lendes. I propozoi Gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë të dënohet sipas Ligjit, dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari Q. G. : **me dt. 13.11.2017**, rreth orës 13.00 në fsh.M. K Gjakovë, shkel Ligjin për Mbrojtje dhe Mjedisin, i cili garanton të drejtën çdo personi për një mjedis ekologjikisht të pranueshëm dhe të shëndosh, si e drejtë themelore kushtetuese në atë mënyrë që pasi i merr mbeturinat (mbetjet materialit ndërtimor) nga një person tjetër, të njëjtat i hedh buzë lumit “E”, veprime këto që ndotin mjedisin, jetën dhe shëndetin e njeriut.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari,

pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është baba i 2 fëmijëve, është mbajtës i vetëm i familjes prej 6 anëtarësh, i gjendjes së dobët ekonomike, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprat e tilla, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së. Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 2(dy) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1(një) viti të mos kryej ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr. 73/18 më datë 31.08.2018**

**Procesmbajtësja,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.